£S1-597-TR

# FORMULAR VETËDEKLARIMI

## PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

**DATË:02/03/2021**

## I. TË DHËNAT PERSONALE

### A. Gjenealitetet aktuale

| | |
|---|---|
| **EMËR** | BESNIK |
| **MBIEMËR** | JAKAJ |
| **ATËSI** | TONIN |
| **AMËSI** | LULË |
| **DATËLINDJE** | 10.10.1972 |
| **VENDLINDJE** | LEVOSHE, PUKE |
| **VENDBANIM** | RRUGA "GJERGJ LEGISI", ND.051, H.1, NJËSIA ADM. NR.11, TIRANË |
| **NR. ID** | H21010211E |

### B. Gjenealitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. *Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.*)

| | |
|---|---|
| **EMËR** | ------------------------ |
| **MBIEMËR** | ------------------------ |
| **ATËSI** | ------------------------ |
| **AMËSI** | ------------------------ |
| **DATËLINDJE** | ------------------------ |
| **VENDLINDJE** | ------------------------ |

Besnik Jakaj

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

## II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a **BESNIK TONIN JAKAJ**, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

**a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.**

**b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.**

**c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.**

**ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.**

**d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.**

**e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.**

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

***KUJDES*: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARI!**

Besnik Jakaj

*(emër, mbiemër, nënshkrim)*

Besnik Jakaj

(emër, mbiemër, nënshkrim)

## III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. ***A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Gjykata | Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë | Masa e dënimit me burgim | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | |
| | | | Neni | Lloji |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

2. ***A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Të dhënat e vendimit gjyqësor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar | Gjykata | Vepra penale për të cilën jeni dënuar | | Vendimi përfundimtar/Dënimi |
| | | Neni | Lloji | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

3. ***A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?** (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

4. ***A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?** (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [x] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Organi procedues | Qyteti, Shteti | Arsyet | Periudha/Data | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|
| GJYKATA E RRETHIT TIRANË | TIRANË | PROCEDIM PENAL NR.516, DATE 30.03.1999, PËR VEPRAT PENALE TË KUNDËRSHTIMIT TË PUNONJËSIT TË POLICISË, KANOSJES PËR SHKAK TË DETYRËS DHE FYERJES PËR SHKAK TË DETYRËS, PARASHIKUAR RESPEKTIVISHT NGA N.236/2, 238, | 1999 | VENDIM NR.214 DT. 23.03.2001 SI MË POSHTË: PUSHIMIN E GJYKIMIT PËR VEPRAT PENALE TË FYERJES PËR SHKAK TË DETYRËS. DEKLARIMIN E PAFAJSHËM PËR VEPRAT PENALE TE KUNDËRSHTIMIT TË PUNONJËSIT TË POLICISË DHE KANOSJES PËR SHKAK TË DETYRËS |

Besnik Lokaj ____________ **(emër, mbiemër, nënshkrim)**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 239/2 I K.PENAL | | |
| | | | | |
| | | | | |

5. ***<u>A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?</u>*** *<u>(Vendos X përbri përgjigjes)</u>*

PO [ X ] JO [ ]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË | PËRGJIGJE | |
|---|---|---|
| | *Aktualisht në fuqi* | *E revokuar* |
| Ndalimi i daljes jashtë shtetit | ☐ | ☐ |
| Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore | ☐ | X |
| Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar | ☐ | ☐ |
| Garancia pasurore | ☐ | ☐ |
| Arresti në shtëpi | ☐ | ☐ |
| Arresti në burg | ☐ | ☐ |
| Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik | ☐ | ☐ |

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Gjykata | Qyteti, shteti | Vepra penale për të cilën akuzoheshit | | Vendimi përfundimtar | Periudha, data |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Neni | Lloji | | |
| GJYKATA E RRETHIT TIRANË | TIRANË | 236/2 | KUNDËRSHTIMIT TË PUNONJËSIT TË POLICISË | DEKLARIMIN I PAFAJSHËM PËR VEPRËN PENALE KUNDËRSHTIMIT TË PUNONJËSIT TË POLICISË | 20.01.2000-19.12.2000 |
| GJYKATA E RRETHIT TIRANË | TIRANË | 238 | KANOSJES PËR SHKAK TË DETYRËS | DEKLARIMIN I PAFAJSHËM PËR VEPRËN PENALE KANOSJES PËR SHKAK TË DETYRËS | 20.01.2000-19.12.2000 |
| GJYKATA E RRETHIT TIRANË | TIRANË | 239/2 | FYERJES PËR SHKAK TË DETYRËS | PUSHIM I GJYKIMIT PËR VEPRËN PENALE TË FYERJES PËR SHKAK TË DETYRËS | 20.01.2000-19.12.2000 |

Besnik Lackaj

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

6. ***A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Autoriteti urdhërues | Arsyeja | Qyteti, Shteti | Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo) |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

7. ***A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?***
*(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja dëbimit | Periudha e dëbimit nga shteti i huaj | Të dhanat e aktit të dëbimit |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

***8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*** *(Vendos X përbri përgjigjes)*

PO [ ] JO [X]

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

| Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar | Arsyeja | Periudha | Adresa e vendqendrimit |
|---|---|---|---|
| | | | |

Besnik Lockaj

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

(emër, mbiemër, nënshkrim)

*<u>Shënim</u>: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjitini një kopje të tyre këtij Formulari.*

*Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto aq pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.*

**(emër, mbiemër, nënshkrim)**

Model – 07

# Jetëshkrimi i kandidatit
# për deputet/kryetar bashkie/anëtar në këshillin e bashkisë

Emër: Besnik
Atësia: Tonin
Mbiemër: Jakaj
Datëlindja: 10/10/1972
Vendlindja: Iballë, Pukë

Kandidat për **DEPUTET** në zgjedhjet për **KUVEND** , të datës **25.04.2021** zonën zgjedhore **Qarku TIRANË.**

**Arsimi:**

2017- Proces Doktorature.

2008-2010: Ka ndjekur Shkollën Post Universitare të Mjekësisë.

2000-2003: I specializuar për Nefrologji dhe ka marrë titullin mjek Nefrolog.

1992-1998: I diplomuar për mjekësi të përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës.

**Eksperienca në punë:**

2018-2019: Drejtor Marketingu pranë Med Impex Sh.P.K në Prishtinë.

2013-2017: Drejtor i Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2012-2013: Drejtor Ekzekutiv pranë Med Impex.

| | |
|---|---|
| 2007-2012: | Drejtor i Përgjithshëm pranë Qendrës Kombëtare e Kontrollit të Barnave. |
| 2006-2007: | Drejtor i Përgjithshëm pranë ISHP. |
| 2005-2006: | Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Edukimit ne vazhdim ne Ministrinë e Shëndetësise. |
| 2003-2005: | Mjek Nefrolog pranë Qendrës Spitalore Nënë Tereza. |
| 1999-2000: | Mjek Familje. |

**Kualifikimi:**

| | |
|---|---|
| 2005-2006: | Kurs 6 mujor me kohë të plotë për Menaxhues dhe Drejtues të Sistemi Shëndetësor nga Universiteti i Monreal i Kanadasë dhe kooperacioni i Zvicerian. |

**Aktivite shoqërore dhe politike:**

| | |
|---|---|
| 2020-2021: | Koordinator dhe Drejtues Politik i njësisë 11 dhe i njësisë 5 të Qarkut Tiranë. |
| 2020-2021: | Anëtar i Kryesisë i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Bashkia Tiranë. |
| 2012-2021: | Mbështetës aktiv i Lëvizjes Socialiste për Integrim. |
| 1999-2012: | Anëtar i Këshilllit Kombëtar në Partinë Demokratike të Shqipërisë. |
| 1998-2012: | Drejtues Politiki i rrethit të Pukës dhe i njësisë numër 4 në Tiranë për Partinë Demokratike të Shqipërisë. |

1998-2012: Anëtar i Kryesisë i Forumit Rinor te Partisë Demokratike të Shqipërisë.

**BESNIK JAKAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 346 AKTI

Nr. 214 Vendimi

# VENDIM
## "NE EMER TE REPUBLIKES"

Kolegji penal i gjykates se Rrethit Tirane i perbere nga :
Kryetar - Fehmi Petku
Anetar - Elvis Kotini
Anetar - Artan Broci

Asistuar prej sekretares Orjana Cufaj, ne prani te prokurorit Shkelqim Ganaj, sot me dt. 23.03.2001 mori ne shqyrtim ne séance gjyqsore ceshtjen penale qe i perket:

TE PANDEHURIT: Besnik Jaku, i biri i Toninit dhe i Lules, dtl.1972, lindur ne Puke, e banues ne Tirane , Rr. Q.Studenti" Godina Nr.4, beqar, student ne vitin e gjashte te fakultetit te Mjeksise Tirane, i padenuar me,pare, brojtur ne gjykim nga av. Qazim Gjonaj.

AKUZUAR : Per veprat penale te kundershtimit te punonjsit te policise , kanosjes per shkak te detyres dhe fyerjes per shkak te detyres, parashikuar respektivisht nga N.236/2 , 238, 239/2 i K.Penal.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata degjoi prokurorin Shkelqim ganaj i cili kerkoi pushimin e gjykimit per te tre veprat pasi per veprat e parashikuara nga nenet 236/2 dhe 238 K.Penal nuk u provua akuza ndersa per vepren penale te parashikuar nga N.239/2 K.penal , i demtuari hoqi dore nga ankimi i bere.

Aokati mbrojtes dhe i pandehuri dakort me kerkesen e prokurorit.

Pasi analizoi ne teresi ceshtjen gjykata,

## VEREN

Se organi i Prokurorise Tirane ne daten 30.03.1999 ka regjistruar procedimin penal nr.516 ne ngarkim te te pandehurit Besnik Jaku, nen akuzat e mesiperme dhe ne perfundim te hetimeve ka paraqitur kerkesen per gjykimin e ceshtjes para gjykates se rrethit Tirane,ne mungese te te pandehurit.

Gjykata e Rrethit Tirane me vendimin Nr.13 date 20.01.2000 ka vendosur deklarimin fajtor te te pandehurit sipas neneve 236/2 , 238, 239/2 K.penal respektivisht me 3 vjet burgim, me 3 muaj burgim dhe 6 muaj burgim dhe ne zbatim te N.55 K.penal ne bashkim te denimeve e ka denuar perfundimisht me tre vjet burgim duke u gjykuar i pandehuri ne mungese.

Kunder ketij vendimi ka bere ankim i pandehuri ne Gjykaten e Apelit Tirane, e cila me vendimin e saj Nr.547 dt.19.12.2000 ka vendosur prishjen e vendimit Nr. 13 date 20.01.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane dhe gjykimin e ceshtjes nga nje tjeter trup gjykues.

Nga rigjykimi i ceshtjes rezultoi se : ne daten 29.03.1999 i pandehuri si pasagjer po shkonte ne Q.Studenti me nje makine Benz, me targe te Krujes pasi duke qene student ne fakultetin e Mjeksise banonte ne Godinen Nr.4 te Q.Studenti.

Tek postblloku ne hyrje te "Q.Studenti" patrulla e policise e perbere nga Qamil Ibrahimi dhe Artur Avdullai ka ndaluar drejtuesin e mjetit , pasi nuk lejohej kalimi i automjeteve ne zonen e Qytetit Studenti pa autorizim perkates.

Ne kete moment nga sedilja e pasme ka dale i pandehuri Besnik duke i kerkuar sqarime deshmitaret Qamil Ibrahimi i cili ishte prone e makines dhe po komunikonte me drejtuesin e mjetit.

I pandehuri pas disa replikash ka filluar te shaje punonjesin e policise me fjale fyese ku si rezultat i kesaj punonjesit e policise i kane drejtuar armet ne drejtim te pandehurit dhe duke e kapur ate e kane bllokuar dhe pasi kane njoftuar grupin e gatshem te Q.studenti kane bere shoqerimin e te pandehurit ne polici.

Gjate kohes qe ka ndodhur kjo ngjarje punonjesi i policise eshte demtuar ne pjesen e ballit.

I pyetur me cilesine e deshmitarit para gjykates punonjesi i policise Qamil Ibrahimi pohoi se i pandehuri nuk i kishte goditur ate dhe se plaga qe ai kishte marre ka ardhur si rezultat i tentatives tyre per te bllokuar te pandehurin gjate ngjarjes. Te njejten deshmi beri para gjykates edhe deshmitari Artur Avdullai i cili pohoi se i pandehuri nuk ka goditur njeri por vetem ka share me fjale fyese.

Ne lidhje me fyerjen e bere deshmitari Qamil Ibrahimi e terhoqi ankimin e bere dhe kerkoi qe te pushohet ceshtja per kete veper.

Ne rrethanat e mesiperme prokurori Shkelqim Gani e terhoqi akuzen ne ngarkim te te pandehurit Besnik Jaku per veprat penale te kundershtimit te punonjesit te policise dhe kanosjes per shkak te detyres ,parashikuar nga nenet 236/2 dhe 238 te K.Penal, pasi akuza per keto vepra nuk u provua.

Sa i perket vepres penale te fyerjes per shkak te detyres prokurori kerkoi pushimin e gjykimit pasi i demtuari hoqi dore nga ankimi i bere ndaj te pandehurit.

Ky konkluzion i prokurorit cmohet i drejte nga ana e gjykates.

Keshtu ne lidhje me vepren penale te kundershtimit te punonjesit te policise , parashikuar nga neni 236/2 i K.Penal fajesia nuk u provua.

Vete punonjesit e policise pohuan se nuk ishin kundershtuar nga i pandehuri qofte edhe pa dhune e per rrjedhoje i pandehuri nuk e ka konsumuar vepren penale qe kerkon neni 236/2 i K.Penal.

Sa i perket vepres penale te kanosjes per shkak te detyres edhe kjo veper nuk u provua gjate gjykimit .

Nuk rezultoi nga deshmite e punonjesve te policise te kete patur kercenime nga i pandehuri Besnik , diten e ngjarjes e per me teper te jete perdorur nga i pandehuri ndonje mjet qe te bente kanosjen serioze dhe reale, element keta qe i kerkon neni 238 i K.penal .

Ne rrethanat e mesiperme duke patur parasysh kerkesat e nenit 388/d te K.Pr.Penale i pandehuri duhet te deklarohet i pafajshem per veprat penale te kundershtimit te punonjesit te policise dhe kanosjes per shkak te detyres, parashikuar nga neni 236/2 dhe 238 i K.penal.

Sa i perket kerkeses se prokurorit per pushimin e gjykimit, per vepren penale te fyerjes per shkak te detyres , parashikuar nga neni 239/2 K.Penal, gjykata e gjen te bazuar ne ligj kete qendrim , pasi sipas N.284/1 te K.Pr.penale, ndjekja penale duhet pushuar ne cdo kohe kur i demtuari e terheq ankimin e bere per kete veper.

Ne séance gjyqsore i demtuari Qamil Ibrahimi e terhoqi ankimin per kete veper dhe sipas N.286/2 te K.Pr.Penale ky qendrim eshte i ligjshem e per rrjedhoje ne baze te nenit 387/1 te K..Pr.Penale, m.q se ndjekja penale nuk mund te vazhdoje duhet vendosur pushimi i ceshtjes.

PENALE TIRANE

PER KETO ARSYE

Duke u bazuar ne nenin 387/1 dhe 388 te K.Pr.penale, gjykata

VENDOSI

Pushimin e gjykimit per te pandehurin Besnik Jaku per vepren penale te fyerjes per shkak te detyres, parashikuar nga neni 239/2 i K.penal pasi i demtuari hoqi dore nga ankimi i tij.

Deklarimin e pafajshem te te pandehurit Besnik Jaku per veprat penale te Kundershtimit te punonjesit te policise dhe kanosjes per shkak te detyres, parashikuar nga nenet 236/2 dhe 238 i K.p.

Shpenzimet gjyqsore ne ngarkim te pandehurit.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane, Brënda 10 diteve duke filluar 1 dite pas shpalljes.

U shpall sot me dt. 23.03.2001 Tirane

SEKRETARE
ORJANA CUFAJ

GJYQTARI
FEHMI PETKU

VERTETOHET SE KY VENDIM KA MARRË FORMË TE PRERË 02 04 2001
TIRANË 20.04 2001

VERTETOHE NJESIA ME ORIGJINALIN